



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 433 / prot.
23

Elbasan, me 23.02.2024

VENDIM

Nr 29, datë 23.02.2024

Mbi miratimin e kuotave të pranimit, në programet e studimit të ciklit të tretë doktoratë, për vitin akademik 2024-2025

Bazuar në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, neni 25, pika 7, neni 37, pikat 1 dhe 2, neni 38, pika 1, dhe pika 3, në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 2.7, gërma a,b,c, në Statutin e UE-së "A. Xhuvani" neni 9, gërma h, në propozimet e njëjësive kryesore të UE-së, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 28, datë 23.02.2024 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, në programet e studimit të ciklit të tretë doktoratë, për vitin akademik 2024-2025", Bordi i administrimit në mbledhjen e datës 23.02.2024,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kuotat e pranimit në Universitetin e Elbasanit "A. Xhuvani" për vitin akademik 2024-2025, në programet e studimit ciklit të tretë të studimeve Doktoratë" (tabela 4 bashkëlidhur), gjithsej 12 kuota.
 - a) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë brenda vendit: **11 kuota.**
 - b) Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga trojet: **1 kuota.**
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendrës së Shërbimeve Arsimore për procedura të mëtejshme.
- 2- Ngarkohet Administratori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Dr. Ardian DURMISHI



